

PROJEKTE

Llojet e granteve

UNIKO ofron financime për të mbështetur projekte sipas 6 kategorive kryesore. Secila kategori grantesh është përcaktuar me një qëllim specifik dhe përfshin procedurat dhe lehtësirat përkatëse. Të gjitha llojet e granteve janë subjekt i rregullave standarde që sigurojnë kuadrin ligjor si pjesë e procesit të dhënies së granteve në UNIKO. Këto grante përfshijnë:

- a. *Projektet kërkimore në Universitet* – jepen për propozime origjinale, gjithëpërfshirëse, të përcaktuara mirë, me objektiva të qarta, që ofrojnë rezultate me rëndësi domethënëse, duke siguruar njohuri të reja, të cilat ndikojnë në procesin mësimor dhe kontribuojnë në përparimin shkencor.
 - b. *Projektet me prioritet kërkimin dhe zhvillimin* – synojnë të adresojnë çështje me rëndësi parësore dhe strategjike për mjedisin, industrinë dhe shoqërinë shqiptare. Çështje të tilla identifikohen periodikisht përmes raporteve të fakultetit dhe përcaktojnë fushat prioritare të kërkimit.
 - c. *Projektet kërkimore kombëtare* – këto grante jepen për kërkime në fusha me rëndësi kombëtare dhe janë propozime që përcaktojnë qartë probleme strategjike, shoqërore dhe komunitare të cilat bëhen publike nga Agjencia Kombëtare e Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI).
 - d. *Projekte për infrastrukturën* – këto fonde janë të destinuara për zhvillimin e infrastrukturës kërkimore, laboratorëve dhe burimeve të UNIKO-së, me qëllim krijimin e një mjedisi të përshtatshëm për hulumtime cilësore. Këto grante kanë për qëllim rritjen e burimeve në fakultete, ngritjen e laboratorëve dhe objekteve model, të pajisur me instrumente të teknologjisë së lartë, pajisje moderne, duke u mundësuar fakulteteve të kryejnë studime eksperimentale, analitike dhe didaktike.
 - e. *Projekte të përbashkëta kërkimore* - këto grante promovojnë kërkime të përbashkëta, të realizuara në partneritet me institucione të ndryshme përmes studimeve shumëdisiplinore që kërkojnë bashkëpunim, ekspertizë dhe resurse kombëtare dhe ndërkombëtare. Projekte të tilla përfshijnë marrëveshje ndër-institucionale për trajtimin e përbashkët të çështjeve shkencore dhe sfidave që kërkojnë zgjidhje shkencore përmes kontributit dhe ekspertizës së përbashkët, resurseve dhe shkëmbimit shkencor.
- a. *Projekte kërkimore studimore* – përfshijnë zhvillimin e studimeve universitare dhe pasuniversitare përmes dhënies së granteve për studime që ju jepen studentëve në nivel master ose doktorantëve si dhe talenteve në fushën e shkencës.

2. Njësitë që financohen

Të gjitha njësitë e universitetit, duke përfshirë akademikët, administratën dhe studentët kanë të drejtë të aplikojnë vetëm për një nga kategoritë e granteve bazuar në kriteret e përcaktuara në thirrje.

3. Vlerësimi i propozimit

Këto procedura synojnë të vlerësojnë dy elemente thelbësore për mbështetjen e kërkimit shkencor, së pari, përshtatjen me rregulloret e universitetit, dhe së dyti, ruajtjen e vlerave të sigurimit të cilësisë dhe meritën shkencore të projektit të propozuar. Këto elemente janë baza e vlerësimit të propozimit dhe përfshijnë tri procedura:

- a. *Procesi i shqyrtimit.* Të gjitha projektpropozimet i nënshtrohen procedurave standarde të rishikimit, të ndërmarra nga Njësitë Koordinuese të Kërkimit në nivel fakulteti dhe nga Komisioni i Vlerësimit të Propozimit të Projektit në nivel universiteti. Procesi i shqyrtimit siguron cilësinë e kërkimit (në aspektin e origjinalitetit, vlerës dhe rezultateve të pritshme), meritave shkencore dhe aftësisë së projektit të propozuar për të kontribuar në përparimin shkencor, zgjidhjen e problemeve, rritjen e kapaciteteve dhe përfitimin potencial të rajonit.
- b. *Procesi i zbatimit.* Procedurat dhe udhëzimet standarde mbështesin kërkuesit në implementimin e kërkimit të tyre. Procesi i implementimit përfshin kërkimin kritik të lidhur me burimet dhe kërkesat, veçanërisht të nevojshme nga kërkuesit për të arritur qëllimet e projekteve të tyre. Këto çështje kanë të bëjnë me buxhetin e projektit për pajisjet, shpenzimet operative dhe shërbime të tjera.
- c. *Raportet e projektit.* Është e detyrueshme që drejtuesit e projektit të paraqesin Raportin e Progresit të projekteve gjatë zbatimit të tyre dhe/ose një Raport përfundimtar gjithëpërfshirës në përfundim të tij. Pa dorëzimin e raportit përfundimtar asnjë projekt nuk quhet i përfunduar. Të dy raportet i nënshtrohen një procedure standarde për vlerësimin e zbatimit të projektit.

PROJETET FITUESE PËR FINANCIM NGA TE ARDHURAT E UNIKO

2018-2019

1. **“Filozofia për fëmijë në mendimin reflektues dhe krijues (Rast studimi Bashkia Korçë)”** – Departamenti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, me buxhetin e propozuar prej 115,000 lekësh (nga të cilat 100,000 financim nga të ardhurat e UNIKO dhe 15,000 financim nga burime të tjera)
2. **“Kujdesi social për moshën e tretë në qytetin e Korçës”** – Departamenti i Shkencave Sociale, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, me buxhetin e propozuar prej 146,000 lekësh
3. **“Teknika biokimike të trajtimit të mbetjeve nga industria ushqimore në Rajonin e Korçës”** – Departamenti i Biologji-Kimisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, me buxhetin e propozuar prej 250,000 lekësh

4. **“Kërkim mbi sigurinë ushqimore – Përcaktimi i cilësisë së qumështit të papërpunuar përmes analizave mikrobiologjike”** – Departamenti i Infermierisë, Fakulteti i Shkencave Natyrore dhe Shkencave Humane, me buxhetin e propozuar prej 200,000 lekësh

2019 - 2020

1. **Pasurimi, automatizimi dhe digjitalizimi i bibliotekës shkencore në UNIKO**
– Fakulteti i Bujqësisë, Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Fakulteti i Ekonomisë, Fakulteti i Shkencave të Natyrës dhe Shkencave Humane, Fondi limit: 6,338,050 AL
2. **Instalimi i platformës Office 365 for Education dhe Upgrade i shërbimit të postës elektronike për stafin akademik dhe studentët**